



Analizë e shkurtër: Strategjia kundër Korrupsionit 2009-2011

Organizata për Demokraci, Anti-korrupcion dhe Dinjitet - Çohu!
Mars 2009



Përmbledhje:

Kjo analizë e shkurtër shqyrton procesin e përpilimit dhe aprovimit të Strategjisë kundër Korrupsionit si dhe procesin e përpilimit të Planit të Veprimit kundër Korrupsionit. Në këtë kontekst, kjo analizë do të vë në pah të metat substanciale të këtyre dokumenteve si dhe të procesit në përgjithësi. Kështu, kjo analizë do të argumentoj që procesi i përpilimit të këtyre dokumenteve është përcjellë me të meta thelbësore, e të cilat do të bëjnë që këto dokumente të mos mund të përmbushin synimet e tyre, atë të parandalimit dhe të luftimit të korrupsionit.

Kryesisht të meta thelbësore që e kanë shoqëruar këtë proces kanë qenë mungesa e analizës paraprake mbi infrastrukturën ligjore dhe institucionale kundër korrupsionit si dhe të dokumenteve tjera që prekin këtë fushë. Po ashtu, procesi i përpilimit të këtyre dokumenteve nuk është bazuar në një hulumtim gjithëpërfshirës i cili do të prezantonte nivelin e korrupsionit në Kosovës, shtrirjen e tij në sektorë të ndryshëm si dhe natyrën/formën e shfaqjes së tij. Pa këto të dhëna, siç do të argumentohet në këtë analizë, nuk mund të pretendohet se këto dokumentet kundër korrupsionit do të dhënë efektet e tyre. Si pasojë e mungesës së këtyre të thënave bazike, nuk ka dhe nuk do të ketë koordinim të mirëfilltë të punës në mes akterëve kryesorë në këtë proces.

Veç këtyre, i gjithë ky proces është shoqëruar me mungesë të theksuar të vullnetit politik nga Qeveria aktuale e që rrjedhimisht do të ketë pasoja fundamentale gjatë zbatimit të tyre në praktikë.

Në Grupin për përpilimin e Planit të Veprimit kundër Korrupsionit nuk ka pasë pjesëmarrje të disa akterëve kryesorë si përfaqësues të Partive Politike, sidomos të atyre parlamentare, përfaqësues të Parlamentit, të Gjykatave, të Sindikatave, të Organizatave si Qendra Inteligjente Financiare si dhe të Organizatave të Biznesit, e pa të cilët assesi nuk mund të përpilohen dokumente efektive kundër korrupsionit.

Për më shumë, Strategjia kundër Korrupsionit nuk e vë theksin në disa procese që priten të ndodhin gjatë vitin 2009 dhe 2010 si ndërtimi i Termocentralit “Kosova e Re”, privatizimi i PTK, si dhe dhënia me koncesion e Aeroportit të Prishtinës.

Përgjithësisht, procesi i përpilimit si dhe i aprovimit të këtyre dokumenteve është parë si një qëllim në vetvete, posedim per-se i dokumenteve kundër korrupsionit, por jo si një mjete për parandalimin dhe luftimin e tij. Si pasojë, ka rrezik potencial që këto dokumente në vazhdimësi të keqpërdoren nga Qeveria kinse si mjete për luftimin e korrupsionit si dhe si shprehje e qartë e vullnetit të saj politik. Ndërsa, në realitet këto dokumente assesi nuk të ofrojnë bazë të qëndrueshme për luftimin e korrupsionit, gjithmonë duke i marrë parasysh të metat e procesit të përpilimit të tyre si dhe mangësitë themelore në vet këto dokumente.



Deja vu-ja e Procesit:

Qeveria e Kosovës në fund të viti të kaluar ka aprovuar Strategjinë kundër Korrupsionit 2009-2011, e cila është përpiluar nën drejtimin e Agjensionit Kosovare kundër Korrupsionit. Ndërsa, në shkurt të këtij viti ka filluar përpilimi i Planit të Veprimit kundër Korrupsionit.

Procesi i përpilimit të këtyre dokumenteve ka filluar pa një analizë gjithëpërfshirëse të infrastrukturës ligjore dhe institucionale kundër korrupsionit si dhe të dokumenteve tjera që lidhen me luftën kundër korrupsionit¹ në të cilën do të pasqyroheshin të metat, paqartësitë si dhe kontradiktat që përmbajnë këto dokumente dhe ligje. Ndërsa, dihet se baza ligjore dhe institucionale në fuqi nuk ofron një kornizë adekuate dhe efektive për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit². Për më shumë, nuk ka as analiza apo të paktën përmbledhje të problemeve të secilit institucion apo sektorë që këto dokumentet synojnë tu adresohen me masat e tyre kundër korrupsionit.

Aprovimi i Strategjisë kundër korrupsionit, si dhe tash përpilimi i Planit të Veprimit nuk është paraprirë nga një hulumtim gjithëpërfshirës mbi nivelin e përgjithshëm të korrupsionit në Kosovë, shtrirjen e tij në sektorë të ndryshëm si dhe natyrën/formën e shfaqjes së tij. Në këtë kuptim, përpilimi si dhe aprovimi i këtyre dokumenteve pa këtë analizë mbi gjendjen ekzistuese të infrastrukturës ligjore dhe institucionale dhe të dokumenteve dhe ligjeve tjera si dhe pa një hulumtim gjithëpërfshirës të nivelit të korrupsionit nuk do të jap asnjë efekt praktik në teren. Veç këtyre, nuk kemi studim të kontekstit politikë, social, ekonomik dhe kulturor, e që është parakusht elementarë për përpilimin e këtyre dokumenteve.

Rrjedhimisht, si pasojë e mungesës së këtij informacioni paraprak dhe bazik nuk kemi të dhëna rreth shkaqeve dhe pasojave të korrupsionit. Kështu gjatë përpilimit sidomos të Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, do të kemi pengesa dhe vështirësi që t'i identifikojmë qartazi objektivat dhe prioritete që u përgjigjen rrethanave tona dhe t'i fokusojnë resurset e pakta në ato fusha ku identifikohen si më të prekura nga korrupsioni. Për më shumë, grupet punuese të përpilimit të Planit të Veprimit kundër Korrupsionit po ashtu do të ballafaqohen me konfuzion për sa i përket bashkërenditjes si dhe kombinimit të masave kundër korrupsionit që duhet të ndërmerren. Kështu do të krijohet konfuzion dhe mungesë koordinimi sidomos gjatë zbatimit të tyre.

Mirëpo, çështja e mungesës së analizës si dhe hulumtimit mbi korrupsionin do të krijoj probleme sidomos në fund të projektit. Si do të matet progresi për sa i përket parandalimit dhe luftimit të korrupsionit që mund të kenë arritur këto dokumente përveç se në aspektin

¹ Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekonomisë Jo-formale, procesi i Rishikimit Funkcional të Administratës Publike (FRIDOM), Strategjia si dhe Plani i Veprimit të Reformimit të Sistemit Gjyqësorë, si dhe ligjet dhe dokumentet tjera që në mënyrë direkte apo indirekte kontribuojnë në luftimin e korrupsionit.

² http://www.cohu.org/raporte/COHU_Infrastruktura_ligjore.doc



sasior? Praktikisht, pa një analizë dhe hulumtim paraprak nuk mund të dimë dhe t'i masim përparimet cilësore që janë bërë në luftën kundër korrupsionit. Kështu, në fund do të mjaftohemi vetëm me numërim sasior të masave të ndërmarra por jo edhe në aspektin cilësor se sa këto dokumente kanë arritur qëllimet e tyre.

Realisht, nuk mund të mjaftohemi vetëm me të dhëna të organizatave ndërkombëtare si TI, UNPD, OSCE apo Gallup International, sepse këto të dhëna kryesisht bazohen në përshtypjen e qytetarëve rreth korrupsionit por assesi nuk ofrojnë një analizë të mirëfilltë të shtrirjes si dhe të situatës së përgjithshme të korrupsionit në Kosovë. Këto të dhëna janë vetëm një indikator i prezencës së korrupsionit në Kosovë por jo studime mbi të cilat mund të përpilohen Strategji dhe Plane të Veprimit kundër Korrupsionit. Kurse, raportet³ e Agjensionit Kosovarë kundër Korrupsionit (AAK-së) janë një bazë e mirë por jo e mjaftueshme mbi të cilën mund të përpilohen dokumente kundër korrupsionit. Edhe pse raportet e AKK-së ofrojnë të dhëna rreth rasteve të raportuara të korrupsionit si dhe të sektorëve më të prekur prapëseprapë, këto raporte nuk japin një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të saktë të nivelit të korrupsionit, shtrirjes së tij në sektorë të ndryshëm të qeverisjes si dhe të natyrës apo formës së tij⁴. Po ashtu, këto raporte nuk ofrojnë analiza të infrastrukturës ligjore dhe institucionale kundër korrupsionit, të ligjeve dhe dokumenteve tjera që lidhen me luftën kundër korrupsionit, të kontekstit politik, social ekonomik dhe kulturor si dhe nuk ofrojnë të dhëna mbi lidhjet në mes kapjes së shtetit (**State capture**) dhe korrupsionit politik dhe administrativ.

Edhe raportet⁵ e Auditorit Gjeneral ofrojnë po ashtu një bazë të mirë rreth keqpërdorimeve nëpër institucione të ndryshme. Mirëpo, këto raporte duhet të shqyrtohen si dhe të përfshihen në një analizë paraprake mbi gjendjen ekzistuese në vend, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të përgjithshme të nivelit, sektorëve si dhe të natyrës/formës së keqpërdorimeve nëpër institucione të ndryshme. Po ashtu, këto raporte duhen të krahasohen me hulumtimin mbi korrupsionin i cilit domosdoshmërisht duhet të bëhet para se t'i hyhet procesit të përpilimit të këtyre dokumenteve kundër korrupsionit.

Procesi i përpilimit të dokumente kundër korrupsionit domosdoshmërisht kërkon analiza dhe hulumtime paraprake⁶ në mënyrë që qartazi të mund të identifikohen prioritetet dhe

³ <http://www.akk-ks.org/>

⁴ Raporti vjetorë i AKK-së për vitin 2007 ka vlerësuar që dëmet materiale që iu kanë shkaktuar Buxhetit të Kosovës gjatë këtij viti duke gjykuar sipas rasteve që këta i kanë shqyrtuar ka qenë 30 milion euro. <http://www.akk-ks.org/>. Ndërsa, në një hulumtim të Odes Amerikanë të Kosovës - "Ndikimi i korrupsionit në Komunitetin e Biznesit në Kosovë" Nëntor 2008, vlerësohet se rreth 66% e bizneseve në Kosovë duhet të ofrojnë rryshfet në mënyrë që të funksionojnë efektivisht. Po ashtu, në këtë vlerësim thuhet se ekonomia jo-formale përbën rreth 38% të GDP-së së vendit e që në terma absolut nënkupton se mbi 1 miliard euro që nuk hynë brenda sistemit të rregullt ekonomikë. <http://www.amchamksv.org/> Po ashtu edhe një studim tjetër jep këtë shifër të përafërt të ekonomisë jo-formale. Shih "Një studim mbi shtrirjen dhe Parandalimin e Ekonomisë ilegale dhe Pastrimit të parave në Kosovë" – B&S Europe.

⁵ <http://www.ks-gov.net/oag/reports1.htm>

⁶ <http://www.transparency.org/publications/sourcebook>
http://www.transparency.org/policy_research/ach



objektivat, sektorët më të prekur si dhe natyrën/formën e shfaqjes së korrupsionit. Praktikisht pa këto të dhëna themelore paraprake dokumentet e aprovuara do të jenë shumë të përgjithësuara dhe si pasojë assesi nuk do të shërbejnë si mjete për luftimin e korrupsionit.

Mungesa e këtyre studimeve është parë edhe me Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsionit 2004 – 2007 ku ndër të metat dhe mangësitë kryesore të mos zbatimit të tyre, sipas një analize⁷ të Këshillit të Evropës, ka qenë pikërisht mungesa e studimeve paraprake për sa i përket shtrirjes së korrupsionit në Kosovë.

Si pasojë e mungesës së analizave paraprake nuk do të kemi koordinim të mirëfilltë të institucioneve gjatë përpilimit si dhe gjatë zbatimit praktik të masave kundër korrupsionit të parapara në Planin e Veprimit kundër Korrupsionit 2009-2011. Duhet të kihet parasysh se buxheti për vitin 2009 veç është aprovuar dhe në këtë kuptim do të ballafaqohemi me pengesa praktike të zbatimit të masave që do të parashihen në Planin e Veprimit kundër Korrupsionit. Zbatimi i këtij plani parashihet edhe kosto financiare e cila nuk është paraparë në buxhetin e vitit 2009 apo në ndonjë vendim të Parlamentin të Kosovës apo të Qeverisë.

Për më shumë, Grupet Punuese brenda Ministrisë së Drejtësisë për amandamentimin e dy ligjeve (Ligji kundër Korrupsionit; Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit) si dhe përpilimin e Ligjit për Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik janë formuar dhe kanë filluar punën⁸. Në këtë kuptim, nuk ka asnjë koordinim apo informim në mes këtyre Grupeve si dhe Grupit për përpilimin e Planit të Veprimit. Këto ligje praktikisht janë baza ligjore dhe institucionale kundër korrupsionit dhe medoemos duhet të ketë bashkëpunim dhe koordinim shumë të ngushtë në mes këtyre grupeve në mënyrë që dokumentet kundër korrupsionit të kenë një bazë ligjore adekuate dhe efektive në fuqi kundër korrupsionit.

Strategjia kundër Korrupsionit 2009-2011 nuk e vë theksin në procesin e privatizimit, të shitjes së aksioneve apo dhënies me koncesion të Ndërmarrjeve Publike si dhe të ndërtimit të Termocentralit “Kosova e Re”. Qeveria e Kosovës ka marr vendim⁹ për privatizimin e tyre si dhe për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re” pikërisht gjatë kësaj periudhe kohore sa edhe parashihet të mbuloj Strategjia. Në këtë kontekst, duhet me doemos që theksi të vendoset mbi këto procese si në Strategjinë kundër Korrupsionit po ashtu edhe në Planin e Veprimit. Strategjia kundër Korrupsionit i inkorporon Ndërmarrjet Publike brenda sektorit të III pika V “Financat Publike dhe menaxhimi i Tyre”¹⁰ ku barazohen Agjencitë Buxhetore

⁷ Shih “Opinion Ekspertësh mbi Strategjinë Anti-korrupsion dhe Planin e Veprimit Anti-korrupsion të Kosovës dhe Rekomandime mbi Strukturën dhe Përbajtjen e një Strategjie të re”, Divizioni i krimt Ekonomik, Drejtoria e Bashkëpunimit, Drejtoria e përgjithshme e të drejtave dhe Çështjeve Ligjore, Këshilli i Evropës, Janar 2008.

⁸ Vendimet e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 02-81; 02-82, të datës 28.01.2009.

⁹ Shih Vendimet e Qeverisë - <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,5>.

¹⁰ Shih “Projekt Strategjia kundër Korrupsionit 2009-2011, f. 13.



me Ndërmarrjet Publike. Ndërsa realisht nuk mund të barazohen këto dy organe me karakter krejtësisht të ndryshëm juridik dhe të përfshihen brenda një seksionit të përbashkët.

Po kjo Strategji, dhe si pasojë edhe Plani i Veprimit, nuk e vënë theksin në masat ndëshkimore¹¹ për aktet e korrupsionit. Duke e marrë parasysh nivelin e korrupsionit në vend, si dhe dështimin e dokumenteve paraprake në parandalimin e korrupsionit¹², përfshirja e masave ndëshkimore kundër korrupsionit është kruciale. Në përpilimin e këtyre dokumenteve duhet të punohet nën parimin që korrupsioni të bëhet një iniciativë me rrezik të lartë e cila sjell fitime të vogla. Praktikisht, duhet të bëhet një balancim në mes masave edukuese, parandaluese si dhe atyre ndëshkimore po që se realisht synohet që politikat kundër korrupsionit të japin ndonjë efekt dhe jo që këto masa të fokusohen vetëm në aspektin parandalues.

Strategjia kundër Korrupsionit si dhe Plani i Veprimit nuk e përcaktojnë përgjegjësin e përgjithshme të Qeverisë për zbatimin praktik të masave të parapara. Në këtë kuptim, Grupi i Organizatave ka vërejtur se ka mungesë vullneti politik të shprehur qartazi të Qeverisë për ta mbështetur Grupin Punues për Përpilimin e Planit të Veprimit kundër Korrupsionit. Qeveria, përveç aprovimit të Strategjisë kundër Korrupsionit duhet të marrë një vendim specifik ku shprehë vullnetin si dhe përgjegjësin e saj për implementimin e përgjithshëm të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit kundër Korrupsionit. Qeveria duhet me doemos të marrë një vendim të tillë në mënyrë që në të ardhmen po që se shfaqen probleme gjatë zbatimit të këtyre dokumenteve, Qeveria të mos mundet që fajin t'ia hedh Agjencionit kundër korrupsionit për mos planifikim të mirë të këtyre dokumenteve si dhe masave të parapara duke qenë se ky institucion është bartës i vetëm i procesit. Praktikisht, pa përcaktimin e qartë të titullarit për zbatimin e përgjithshëm të masave kundër korrupsionit lihet hapësirë për ikje apo devijim nga zbatimit i tyre.

Po që se nuk plotësohen këto kushte paraprake, realisht nuk krijohet një infrastrukturë e mirëfilltë mbi të cilën dokumentet kundër korrupsionit bazohen dhe kështu lufta kundër korrupsionit të mund të ketë efekte praktike në teren. Në këtë kontekst, ekziston rreziku permanent që Qeveria në mënyrë sistematike t'i keqpërdor këto dokumente në secilin rast kur ajo kritikohet për mos efektivitet në luftën kundër korrupsionit duke u justifikuar se ka politika kundër korrupsionit.

¹¹ Projekt Strategjia kundër Korrupsionit 2009-2011e vë theksin në **1)** fuqizimin e kapaciteteve institucionale; **2)** masat praktike/administrative si dhe në **3)** monitorimin e zbatimit të legjislacionit tashmë të miratuar, sesa në iniciativa të reja legislative, f. 7.

¹² Strategjia si dhe Plani i Veprimit kundër Korrupsionit 2004-2007 e patën vënë po ashtu theksin vetëm në masa parandaluese.



Përfundim:

Në këtë analizë është argumentuar që procesi si dhe përmbajtja e dokumenteve kundër korrupsionit 2009-2011 ka të meta thelbësore, të cilat do të bëjnë të pamundur përmbushjen e synimeve të tyre, atë të parandalimit dhe të luftimit të korrupsionit. Kjo për faktin se këto dokumente nuk mbështeten në analiza paraprake të gjendjes ekzistuese si dhe në hulumtime që pasqyrojnë nivelin, formën/natyren e shfaqjes, si dhe shtrirjen e korrupsionit në sektorë të ndryshëm. Pa këto të dhëna, siç është thënë më lartë, nuk mund të pretendohet të përpilohen dokumente efektive kundër korrupsionit.

Për më shumë, kjo analizë ka treguar se deri më tani nuk janë identifikuar fushat prioritare se ku dëshirohet të fokusohet në luftën kundër korrupsionit, por karakteri i dokumenteve kundër korrupsionit është shumë i përgjithësuar, gjë që praktikisht do t'i bëjë të pa efektshme. Po ashtu, këto dokumente nuk e vënë theksin në disa procese shumë të rëndësishme që priten të ndodhin gjatë viti 2009-2010 si privatizimi i Ndërmarrjeve Publike apo ndërtimi i Termocentralit "Kosova e Re", si dhe nuk përfshijnë aspektin e masave ndëshkimore. Gjithashtu, kjo analizë ka treguar se ka mungesë të theksuar të koordinimit dhe të bashkëpunimit në mes grupeve të ndryshme që përpilojnë ligje dhe dokumente kundër korrupsionit. Ka vënë në pah mungesën e vullnetit politik të Qeverisë si dhe mungesën e pjesëmarrjes në Grupin Punues për Planin e Veprimit kundër Korrupsionit të disa akterëve kryesorë si Partitë Politike, Sindikatat, Organizatat e Biznesit. Në këtë kuptim, kjo analizë ka tërhequr vërejtjen se këto dokumente do të keqpërdoren nga Qeveria kinse si mjete për luftimin e korrupsionit ndërsa realisht ato nuk ofrojnë një bazë të mirëfilltë për t'i shpallur luftë efektive korrupsionit.

Rekomandime të përgjithshme:

Grupi i Organizatave përpilues të kësaj analize si dhe të kërkesave të paraqitura para Grupit për përpilimin e Planit të Veprimit sugjeron këto rekomandime.

Duke e marrë parasysh fazën në të cilën gjendet procesi i përpilimit të Planit të Veprimit mendojmë që: dokumentet si Strategjia dhe Plani i Veprimit duhet me doemos të jenë vetëm drafte paraprake por assesi dokumente finale, kjo për shkak të të metave që janë identifikuar në to. Në këtë kuptim, Parlamenti i Republikës së Kosovë assesi nuk do të duhej të miratojë Strategjinë kundër Korrupsionit 2009 – 2011 pasi që ky dokument nuk ofron bazë të qëndrueshme kundër korrupsionit.

Mirëpo, paraprakisht do të duhej që të bëhej një analizë e infrastrukturës ligjore dhe institucionale, e ligjeve dhe dokumenteve tjera që në mënyrë direkte apo indirekte kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit si dhe përmbledhje e problemeve dhe keqpërdorimeve në secilin Institucion. Po ashtu, sugjerojmë që të bëhet një hulumtim i cili do të tregonte nivelin, natyrën/formën e shfaqjes si dhe të shtrirje së korrupsionit në



Kosovë. Pasi të bëhet analiza si dhe hulumtimi, të dhënat që dalin nga këto të krahasohen me objektivat si dhe masat e paraqitura në draft Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsionit. Në këtë mënyrë, do të mund të identifikoheshin qartazi objektivat si dhe prioritetet, kështu edhe masat kundër korrupsionit do të fokusoheshin në ato fusha ku identifikoheshin më urgjente dhe kështu resurset do të mund të përdoreshin në mënyrë shumë më efektive.

Kjo punë mund të bëhet brenda vitit 2009 dhe në asnjë mënyrë nuk e dëmton procesin e deritanishëm por shërben si një bazë e qëndrueshme mbi të cilën mund të ndërtohen politika efektive kundër korrupsionit. Për më shumë, rekomandimi përkon edhe me rrjedhën e ngjarjeve sepse buxheti për vitin 2009 është aprovuar, i cili nuk ka paraparë ndonjë linjë të posaçme për zbatimin e këtyre dokumenteve kundër korrupsionit. Ndërsa, po që se periudha kohore 2009 përdoret për bërjen e këtyre punëve paraprake do të na mundësonte që edhe koston financiare ta kemi të përcaktuar qartazi kështu edhe të parashihet në buxhetet e viteve vijuese.

Veç këtyre rekomandimeve të përgjithshme, Grupi i Organizatave ka përpiluar edhe një listë me 15 rekomandime konkrete të cilat janë parakushte thelbësore për ndërtimin e politikave të qëndrueshme dhe efektive kundër korrupsionit. (**shih Aneksi I**)



(Aneksi I)

Rekomandime:

Duke i pasur parasysh mangësitë e shumta gjatë procesit të përpilimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit si dhe të metat në vet këto dokumente, ÇOHU! paraqet disa rekomandime thelbësore para organeve vendim-marrëse. Këto rekomandime janë përpiluar pas një analize që iu kemi bërë dokumenteve të lartë përmendura si dhe procesit të përpilimit të tyre. Këto rekomandime janë parakushte themelore pa të cilat dokumentet e përpiluara kundër korrupsionit nuk do të kenë një bazë të qëndrueshme ku mund të bazohen, kështu nuk do të mund t'i japin efektet e tyre atë të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.

I

Të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse e gjendjes ekzistuese e cila do të përfshinte, por që nuk do të kufizohet vetëm në këto fusha: Infrastrukturën Ligjore dhe Institucionale kundër Korrupsionit; dokumentet si Plani i Veprimit për Parandalimin e Ekonomisë Jo-formale, Strategjinë dhe Planin e Veprimit të Reformimit të Sistemit Gjyqësorë, Procesin e Rishikimit Funkcional të Administratës si dhe ligjet dhe institucioneve të tjera që në mënyrë direkte apo indirekte kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit, lidhjet ndërmjet kapjes së shtetit (**State Capture**) dhe korrupsionit politik dhe administrativ, lidhjet ndërmjet korrupsionit politik dhe krimit të organizuar, etj.

II

Të bëhet një hulumtim i cili do të ofronte të dhëna mbi nivelin e korrupsionit, shtrirjen e tij në sektorë të ndryshëm si dhe natyrën/formën e shfaqjes së tij.

III

Të bëhet një përmbledhje e problemeve dhe e keqpërdorimeve në secilin sektorë veç e veç në mënyrë që të mund të identifikohen edhe masat adekuate të cilat duhet të ndërmerren për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në këta sektorë.



IV

Qeveria e Kosovës duhet të shprehë qartazi vullnetin e saj politik për përpilimin dhe zbatimin e këtyre dokumenteve duke marrë një vendim specifik për këtë çështje, si dhe të delegoj një përfaqësues politik në grupet punuese për përpilimin e planit të Veprimit kundër Korrupsionit.

V

Të specifikohen qartazi në Strategjinë dhe në Planin e Veprimit kundër Korrupsionit, si dhe në vendimin e Qeverisë, përgjegjësia e përgjithshme e saj për implementimin e këtyre dokumenteve si dhe, përgjegjësia e organeve të veçanta veç e veç.

VI

Qeveria të kërkoj në vendimin e saj që të gjitha organet publike qendrore si dhe lokale të emërojnë nga një përfaqësues si dhe të obligohet pjesëmarrja e tyre në grupet punuese.

VII

Përfaqësuesit e Komunave të Kosovës të marrin pjesë në grupet punuese.

VIII

Të gjitha Partitë Politike, sidomos ato parlamentare, të emërojnë nga një përfaqësues në grupet punuese në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e procesit.

IX

Edhe pas përpilimit dhe aprovimit të Plani të Veprimit kundër Korrupsionit, Organizatat e shoqërisë civile që marrin pjesë në grupet punuese të përfshihen në konkretizimin e masave të parapara në këtë dokument sidomos në ato fusha ku mund të japin kontributin e tyre, sepse vlerësojmë që puna për krijimin e kornizës kundër korrupsionit nuk përfundon me aprovimin e këtij Plani.



X

Të formohet një grup permanent që përfshinë nga një pjesëmarrës të secilit organ pjesëmarrës në Grupet Punuese dhe i cili pas aprovimit të këtyre dokumenteve kundër korrupsionit monitoron në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e tyre dhe jo që monitorimin t'i lihet vetëm Agjensionit Kosovarë kundër Korrupsionit.

XI

Masat apo treguesit e suksesit të parapara në Planin e Veprimit kundër Korrupsionit të jenë të qarta dhe të matshme sidomos në aspektin cilësorë.

XII

Të përfshihen si në Strategji po ashtu edhe në Planin e Veprimit kundër Korrupsionit monitorimi i gjithë procesit të privatizimit, shitjes së aksioneve apo të dhënies me koncesion të Ndërmarrjeve Publike, si dhe procesi i ndërtimit të termocentralit “Kosova e Re”.

XIII

Të theksohet në këto dokumente sidomos luftimi i **korrupsionit politik**.

XIV

Domosdoshmërisht të përfshihen në këto dokumente edhe **masat ndëshkimore** për aktet e korrupsionit, sepse vlerësojmë se fokusimi vetëm në masa parandaluese nuk është i mjaftueshëm sidomos duke e marrë parasysh nivelin e shtrirjes së korrupsionit si dhe përfshirjen e zyrtarëve të lartë në akte korruptive.

XV

Të merren parasysh rekomandimet e vlerësimit të Strategjisë si dhe të Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2004-2007 të bëra nga Këshilli i Evropës.